

Muaz Agushi, PhD<sup>1</sup>

UDC: 342.8

## SISTEMI MAZHORITAR: PËRPARËSITË DHE MANGËSITË E KËTIJ SISTEM

## МНОЗИНСКИ СИСТЕМ: ПРЕДНОСТИ И НЕДОСТАТОЦИ НА ОВОЈ СИСТЕМ

## MAJORITYAN SYSTEM: ADVANTAGES AND DISADVANTAGES OF THIS SYSTEM

### Abstract

The election system of every country is related to the character of its social and state regulation. The more democratic the election system is, the more democratic is namely the social and state regulation of that country. In the time of democracy which is based on free vote and the will of the people, elections are the only legitimate means to govern.

Frequently, the question arises which of the electoral systems is the best. Different researches admit that there is no single electoral system that meets the ambitions and responds to all countries, since political systems and electoral processes are subject to historical, political, cultural and religious factors.

The purpose of this study is to deal in more detail the majoritarian electoral system, which is historically known as the first electoral system that is based on the principle of the majority and which is considered the simplest of all electoral systems.

**Keywords:** *election systems, the system of majority, majoritarian system, elections, democracy*

---

<sup>1</sup> Asistent profesor në Fakultetin e Shkencave Islame, Shkup.  
ORCID ID: 0000-0002-9841-9226 Email: muaz\_agushi@hotmail.com

## Hyrje

Vetë natyra e sistemeve politike bashkëkohore ka imponuar lloje të ndryshme të zgjedhjeve. Por si pikënisje konsiderohet çdo herë mënyra e shfrytëzimit të drejtës së përgjithshme të votës dhe respektimi i normave dhe standardeve që bëjnë votën e qytetarit të lirë dhe konkurruese. Nëse nuk respektohen këta dy komponentë, atëherë lirisht themi se zgjedhjet nuk mund të sigurojnë legjitimitetin e të zgjedhurve dhe nënkuptohet legjitimitetin e institucioneve përfaqësuese që formohen pas zgjedhjeve.

Sistemi zgjedhor mund të përcaktohet si “përmbledhje normash dhe procedurash që aplikohen gjatë zgjedhjes së bartësve të funksioneve të caktuara të pushtetit politik”.<sup>2</sup> Pra, sistemet zgjedhore në kuptimin e ngushtë të fjalës nënkuptojnë rregulla dhe metoda, të cilat shërbejnë për të shndërruar votat e hedhura për një parti politike gjatë zgjedhjeve elektorale në poste të fituara, kjo në kuadër të institucioneve të sistemit politik.

Zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore nuk janë diçka të përkryera dhe unike, por ato dallojnë nga shteti në shtet në varësi të kushteve, rrethanave dhe vetë karakterit të sistemit politik. Nuk mund të thuhet se sistemi zgjedhor në sistemet presidenciale dhe forma e organizimit të zgjedhjeve është plotësisht e njëjtë me zgjedhjet dhe sistemin zgjedhor në sistemet parlamentare. Dallimet janë të dukshme edhe ndërmjet sistemeve politike të njëjta. Si shembull e kemi rastin zgjedhjet për president, ku për shkak të sistemit zgjedhor, ekzistojnë dallime të qarta ndërmjet SHB-ve dhe shteteve tjera që praktikojnë sistemin politik presidencial.

Sistemi zgjedhor duhet të sigurojë kushte për organizimin e zgjedhjeve, ndërsa zgjedhjet janë ata që bëjnë testimin e vullnetit të qytetarëve, duke u dhënë atyre mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejt të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në parlament dhe institucionet tjera të shtetit.<sup>3</sup>

Pavarësisht rëndësisë tejet të madhe që kanë zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore për funksionimin e sistemeve politike bashkëkohore, ato nuk duhen idealizuar, apo identifikuar me demokracinë dhe as të presupozohet se ato me çdo kusht e bëjnë demokracinë të mundshme.

---

<sup>2</sup> V. Vasović, V. Goati, “Izbori i izborni sistemi”, Beograd, 1993, f. 122.

<sup>3</sup> Etem Aziri, “Sistemi Politik i Republikës së Maqedonisë: formimi, sfidat dhe prespektiva e zhvillimit demokratik”, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012, f. 27.

## Llojet e sistemeve zgjedhore

Sot në kohën e demokracisë, që bazohet në votën e lirë dhe në vullnetin e popujve, zgjedhjet janë i vetmi mjet legjitim për të qeverisur. Struktura politike e një vendi dhe procesi i formimit të vullnetit politik mund të ndikohen në mënyrë vendimtare nëpërmjet përpunimit të sistemit zgjedhor, sepse sikurse rendi brendapartiak, edhe raporti mes partive dhe marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe parlamentit varen nga sistemi zgjedhor. Nga ana tjetër, traditat e caktuara politike, gjendjet historike dhe kushtet shoqërore lejojnë vetëm sisteme të caktuara zgjedhore. Aplikimi universal i çdo sistemi zgjedhor nuk është i mundshëm. Manipulimi i sistemit zgjedhor pa marrë parasysh strukturat konkrete, gjendjen politike dhe sociale të qytetarëve rrezikon humbjen e funksionit të vërtetë të zgjedhjeve, nëse sistemi zgjedhor nuk pranohet si i ligjshëm nga pakica.<sup>4</sup>

Sistemet zgjedhore ndryshojnë në varësi të dimensioneve kryesore, ku përfshihen madhësia e zonave zgjedhore, format e votimit, përcaktimi i pragueve zgjedhore, madhësia e asamblesë parlamentare, listat e hapura apo të mbyllura të votimi, etj. Por kriteri apo dimensionet kryesorë mbetet zbatueshmëria e formulës zgjedhore.

Ekziston një numër i madh i sistemeve zgjedhore si dhe forma të shumta që mund të kombinohen në mes tyre. Politologët dhe ata që merren më studimin e sistemeve zgjedhore kanë dhënë një numër të madh kombinimesh për sistemet kryesore zgjedhore dhe nënsistemet që dalin prej tyre. Madje shumë herë kanë pasur mendime dhe qëndrime të kundërta se ekzistojnë dy, tri apo edhe katër lloje të sistemeve zgjedhore.

Disa autorë veçojnë dy tipa kryesorë të sistemeve zgjedhore edhe atë, sistemin proporcional dhe sistemin mazhoritar, duke përmendur dhe formën e kombinuar të tyre, që do të thotë sistemin zgjedhor të përzier, ndërsa autorë të tjerë përmendin tre tipa të sistemeve zgjedhore, por me një ndryshim duke e trajtuar sistemin e përzier (gjysmë proporcional) si tip të veçantë.<sup>5</sup> Ndërsa një grup tjetër politologësh sistemet zgjedhore i ndajnë në katër grupe edhe atë, në sistemin mazhoritar (First-past-the-post-System), sistemin gjysmë proporcional (SNTV),

<sup>4</sup> Vladimir Goati, "Politické Partije i Izbori u Demokratskom Poretku", izdavač Centar za slobodne izbore i demokratiju – CeSID, Beograd, 2001, f. 56.

<sup>5</sup> Oreta Saliaj, "Ndikimi i zgjedhjeve dhe sistemit zgjedhor në demokrazimin e sistemit politik të Republikës së Shqipërisë", Tiranë, 2014, f. 55.

sistemin proporcional (D'hondt-it) dhe sistemin e përzier (Single-Transferable Vote).<sup>6</sup>

Llojet e lartpërmendura përmbajnë dhe shumë nënvariante tjera që janë pjesë përbërëse e sistemeve zgjedhore, që në këtë punim do të mundohemi më gjerësisht të flasim për secilën nga këto lloje dhe ndarjet e tyre në përgjithësi.

### **Sistemi mazhoritar (sistemi i shumicës)**

#### *Kuptimi*

Sistemi mazhoritar konsiderohet si, njëri prej sistemeve zgjedhore i cili është përdorur për herë të parë në praktikën parlamentare. Nëse shohim në aspektin historik zgjedhjet e para parlamentare janë mbajtur sipas sistemit mazhoritar.<sup>7</sup> Si për kah kohëzgjatja e aplikimit të tij, ashtu edhe për kah numri i shteteve që aplikojnë edhe sot, është njëri prej sistemeve kryesore zgjedhore. Deri në fund të shekullit XIX, regjime të ndryshme parlamentare përdornin kryesisht dy tipa të sistemeve kryesore mazhoritare. Vendet anglo-saksone dhe latino-amerikane si dhe Danimarka, Suedia, përdornin votimin mazhoritar një emëror me një raund, ndërsa regjimet e tjera parlamentare të Evropës kontinentale, si Franca, Norvegjia, Austria preferonin sistemin mazhoritar me dy raunde.<sup>8</sup>

Në bazë të elementeve kryesore strukturore, numrit dhe llojit të zonave zgjedhore, formës e konkurrencës zgjedhore dhe strukturës së votimit, autorët e ndryshëm ofrojnë një shumëllojshmëri të klasifikimeve të ndryshme të sistemit zgjedhor të shumicës.<sup>9</sup>

Dallim nga sistemi proporcional, në sistemin mazhoritar, nëse aplikohet sistemi i pari i listës merr postin, zona zgjedhore ndahet në po aq qendra zgjedhore, sa është edhe numri i ofruar i vendeve në parlament dhe zona zgjedhore shumëkandidatshe nëse aplikohen tipa të tjerë të sistemit mazhoritar. I zgjedhur konsiderohet ai kandidat që në zonat zgjedhore ka fituar ose shumicën absolute ose shumicën relative të votave. Këtë në kushte normale, e arrijnë kryesisht kandidatët që mbështeten nga partitë e mëdha apo koalicionet e bashkuara. Edhe pse sistemi mazhoritar nuk mund t'i prodhojë sistemet dypartiake, ai i ruan

<sup>6</sup> The Report of the Independent Commission on the Voting System,

<http://www.officialdocuments.co.uk/document/crn40/4090/contents.htm>. October, 1998.

<sup>7</sup> Vladimir Goati, "Politicke Partije i Izbori u Demokratskom Poretku", izdavač Centar za slobodne izbore i demokratiju – CeSID, Beograd, 2001, f. 56.

<sup>8</sup> Ylli Bufi, "Tempulli i demokracisë", OMBRA GVG, Tiranë, 2010, f. 185.

<sup>9</sup> "Izborna enciklopedija Izborni pojmovnik", f. 43.

dhe i siguron ato. Në kushte të tilla, në zgjedhje votuesi vendos mes dy programeve dhe grupeve të ndryshme qeveritare.

Sistemi mazhoritar i zgjedhjeve i jep shpesh mundësinë një shumice përkatëse të ngushtë të ketë një përfaqësim tepër të lartë në parlament. Në Angli ka ndodhur që Partia Konservatore me 38,2% të votave të fitojë mbi 56% të vendeve në parlament. Përveç kësaj, ky sistem zgjedhor pengon realizimin e përfaqësimit parlamentar të pakicave, në rast se ato nuk janë në shumicë të paktën në disa zona zgjedhore.

Element kryesor që dallon sistemin mazhoritar nga sistemet tjera elektorale është sepse gati gjithmonë përdor zonat e vogla elektorale, përkatësisht zonat më të vogla në krahasim me sistemin e pastër proporcional, me lista të mbyllura, ku zakonisht përdoret një zonë e vetme elektorale.<sup>10</sup>

#### *Variantet (llojet) kryesore të sistemit mazhoritar*

Në mesin e shkencëtarëve dhe specialistëve të sistemeve zgjedhore nuk ekziston një pajtueshmëri e plotë sa u përket varianteve të sistemeve mazhoritare. Disa autorë përmendin vetëm dy variante bazë të këtij sistemi, edhe atë sistemin e shumicës relative dhe sistemin e shumicës absolute. Disa autorë të tjerë përmendin tre variante të sistemit të shumicës: sistemin e shumicës së thjeshtë, sistemin dy raundesh dhe sistemin e votimit alternativ.<sup>11</sup> Ndërsa grupi i tretë i autorëve përmend pesë nënvariate të sistemit zgjedhor të shumicës dhe atë: i pari që fiton postin, vota bllok, vota bllok partiake, vota alternative dhe sistemi dy raundesh.<sup>12</sup> Gjatë klasifikimit të varianteve të sistemit zgjedhor të shumicës, autorët kanë pasur si pikënisje mënyrën e organizimit të votimit dhe mënyrën e mbledhjes së votave.

#### *I pari i listës fiton postin*

Varianti “I pari i listës fiton postin” (First Past The Post System), autorët e kanë emëruar me emra si, “sistemi i shumicës së thjeshtë”, “i pari ia del”, “sistemi mazhoritar një kandidat” ose “sistemi zgjedhor më njësi njëemërore” etj. Ky variant parqet variantin më të lehtë të sistemit zgjedhor mazhoritar në përgjithësi sepse fituesi është kandidati që ka

<sup>10</sup> Sadik Haxhiu, “Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)”, Prishtinë, 2013, f. 188-189.

<sup>11</sup> Andrew Heywood, “Politika”, Prishtinë, 2008, f. 215-217.

<sup>12</sup> Andrew Reynolds, Ben Relly, Andrew Ellis, “Electoral System Design: The New International Idea Handbook”, Stockholm, 2008.

më së shumti vota në raport me kandidatet tjerë në garë, por jo medoemos shumicën absolute të votave.<sup>13</sup> Ky sistem zgjedhor i shumicës nënkupton ndarjen e trupit zgjedhorë në njësi më të vogla, në të cilat zgjidhet nga një deputet, pra një përfaqësues në parlament. Numri i njërive zgjedhore një-emërore është i barabartë me numrin e personave që duhet të zgjidhen në organin ligjvënës. Çdo votues disponon një votë dhe zgjedh njërin nga kandidatët, ndërsa fitues konsiderohet kandidati i cili ka fituar më shumë vota në krahasim me kandidatët tjerë të së njëjtës njësi zgjedhore. Votuesit pasi tërheqin fletën e votimit duhet të rrethojnë emrin e kandidatit që preferojnë, ose të bëjnë një shenjë të caktuar siç është parashikuar me ligj, si dhe të hedhin fletën e votimit në kutinë e votimit. Sipas këtij sistemi kandidati fitues, duhet të ketë vota më së shumti, në raport me kandidatët tjerë në atë zonë elektorale, por nuk është përcaktuar limiti se, sipas së cilës përqindje fitohet mandati: p.sh. 45% apo 50% +1 të votave të fituara. Teorikisht mandati mund të fitohet automatikisht me dy vota, nëse të gjithë kandidatët e tjerë në garë në atë zonë zgjedhore kanë fituar vetëm nga një votë, me kusht që të mos kërkohet pragu zgjedhor i daljes në zgjedhje.<sup>14</sup> Normalisht një dukuri e tillë nuk ndodh në praktikë sepse vë në pikëpyetje legjitimitetin e kandidatit të zgjedhur dhe ndodh shpërfillja e skajshme e sovranitetit të popullit, si një parim me vlerë e demokracive bashkëkohore.

Ky variant i sistemit të shumicës i përgjigjet më shumë sistemit dypartiak ku zakonisht nuk formohen qeveri të koalicionit, por partia që fiton zgjedhjet formon qeverinë, ndërsa partia që ka humbur zgjedhjet në parim luan rolin e opozitës konstruktive. Pra, sistemi “I pari merr postin”, ndikon në zvogëlimin e numrit të partive politike dhe si i tillë i përshtatet më shumë partive të mëdha, të cilat në bazë të këtij parimi arrijnë të sigurojnë më lehtë shumicën e nevojshme parlamentare për formimin e qeverisë.

Origjina e këtij sistemi rrjedh prej Britanisë së Madhe, prandaj ky sistem edhe tani, aplikohet në disa shtete që kanë qenë të dominuara nga Britania e Madhe. Ky sistem zgjedhor aplikohet edhe në zgjedhjet kongresiale në SHBA, Kanada, Zelandën e Re, Indi, Malajzi, etj.<sup>15</sup>

<sup>13</sup> “Manues i International IDEA”, vepër e cituar, f. 66.

<sup>14</sup> Etem Aziri, “Partitë Politike, Zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore”, Tetovë, 2015, f. 431.

<sup>15</sup> Sadik Haxhiu, “Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)”, Prishtinë, 2013, f. 192.

## Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Thjeshtësia gjatë procesit të votimit, si për votuesin ashtu edhe për personat e angazhuar në certifikimin e rezultateve përfundimtare.

- Rezultatet zgjedhore llogariten më shpejt në krahasim me sistemet e tjera.

- Ndhomon në krijimin e qeverive kryesisht njëpartiake, sepse gara elektorale zhvillohet në mes dy partive kryesore politike në nivel vendi, ku qeveritë e koalicioneve janë përjashtime e jo rregulla, edhe pse funksionojnë edhe parti të treta.<sup>16</sup>

- Krijon një opozitë koherente parlamentare, ku partia e dytë fiton një numër të mjaftueshëm të deputetëve e denjë për të luajtur rolin e një opozite konstruktive dhe të fuqishme.

- Përjashton nga përfaqësimi parlamentar partitë ekstremiste, përveç në rastin kur elektorati mbështet ndonjë parti minore.

- Rezulton qeverisje të qëndrueshme njëpartiake, ku qeveritë me një parti rrallë bien si pasojë e përçarjeve dhe fërkimeve të brendshme.<sup>17</sup>

- Votuesit japin votën e tyre në favor të kandidatit dhe jo për partinë politike, duke vlerësuar performancën e kandidatëve individual, por jo listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike, siç haset në sistemin zgjedhor proporcional.

- Ofron më shumë mundësi për zgjedhjen e kandidatëve të pavarur.<sup>18</sup>

Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:

- Krijon një numër të madh të votave të dështuara që nuk kontribuojnë për zgjedhjen e ndonjë kandidati. Pra të gjithë kandidatët që kanë humbur në zonën zgjedhore një kandidatëshe votat e tyre u dësh-tojnë apo humbin.

- Përjashton partitë e vogla nga përfaqësimi në parlament që nënkupton indirekt mosrespektimin e vullnetit të një pjese të elektoratit dhe ofron zgjidhje të kufizuar për shkak të prirjeve dypolare.

- Pushteti ekzekutiv koncentrohet te qeveria një partiake, ku në numrin më të madh të rasteve partia fiton një pjesë dërmuese të pushtetit politik të cilën e udhëheq si përfaqësues të shumicës dhe në interes të

<sup>16</sup> "The systems and their consequences, extracted from Electoral system design", New International IDEA Handbook, 2005, f. 36.

<sup>17</sup> Andrew Heywood, "Politika", vepër e cituar, f. 215.

<sup>18</sup> Etem Aziri, "Partitë Politike, Zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore", Tetovë, 2015, f. 433.

saj, kurse pakica e madhe largohet nga pushteti dhe asaj i imponohet roli i opozitës<sup>19</sup>

- Kandidatët e gjinisë femërore kanë më pak gjasa të marrin mandate deputetësh në parlament, pasi përfaqësimi i tyre gjithkund në botë është në disproporcion me përqindjen e votuesve.

- Shumica parlamentare e formuar mbi bazën e këtij sistemi nuk mundëson krijimin e një qeverie me shkallë të lartë legjitimiteti.

### *Vota Bllok*

Vota bllok është një variant i sistemit “I pari i listës merr postin”, i cili përdoret në zonat zgjedhore shumë kandidatëshe. Secili votues ka në dispozicion aq vota sa ka dhe ulëse për t’u plotësuar. Përmes këtij sistemi zgjedhor votuesit kanë mundësi që të bëjnë përzgjedhje të lirë të kandidatëve pavarësisht përkatësisë partiake. Alternativa për përzgjedhje është me e madhe se në sistemet tjera zgjedhore, sepse votuesi nuk është i detyruar që votat e tij t’i hedh vetëm për kandidatët e një partie.

Votimi bëhet në mënyrë të përzier, ku zgjedhësi ka të drejtë të jap votën në favor të kandidatëve të listave të partive të ndryshme, madje ai ka të drejtë të shtojë edhe kandidatë që nuk janë të përfshirë në listat e partive.<sup>20</sup> Kështu p.sh., nëse në një zonë zgjedhore duhet të zgjedhën 5 kandidatë, zgjedhësi ka në dispozicion pesë vota për kandidatët individual. Ai ka mundësi, t’i votojë 5 kandidatët e partisë së njëjtë, por mund të votojë edhe 5 kandidatët e partive të ndryshme. Numërimi i votave bëhet sipas kandidatëve e jo sipas listave. Konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë, të cilët kanë marrë më së shumti vota.

Për dallim nga sistemi “I pari i listës merr postin”, ku partitë e vogla kanë më pak gjasa për të fituar mandate deputetësh, në sistemin “vota bllok” u jepet mundësia më shumë partive të vogla të fitojnë mandate deputetësh. Ky sistem është përdorur në Kuvajt, Ishujt Virgjinia, në SHBA, Maldive, Tongo etj.<sup>21</sup> Për shkak se është vështirë për të bërë përlllogaritje se kush do të fitojë duke pasur parasysh mënyrën komplekse të dhënies së votës, ky sistem zgjedhor rrallë herë aplikohet nëpër botë.

### **Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi**

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Votuesit kanë mundësi që të bëjnë përzgjedhje të lirë se cilët kandidat dëshirojnë t’i votojnë, pavarësisht përkatësisë partiake.

<sup>19</sup> Donatella Della Porta, “Bazat e shkencës politike”, Prishtinë, 2006, f. 100.

<sup>20</sup> Ylli Bufi, “Tempulli i demokracisë”, OMBRA GVG, Tiranë, 2010, f. 189.

<sup>21</sup> Manues i International IDEA, vepër e cituar, f. 36.



▪ Alternative për përzgjedhje është më e madhe se në sistemet tjera zgjedhore, sepse votuesi nuk është i detyruar që votat e tij t'i hedh vetëm për kandidatët e një partie.

▪ Kandidatët që kanë autoritet mund të marrin vota më shumë si individ e jo në emër të partisë politike.

Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:

▪ Partitë politike nuk mund të llogarisin paraprakisht në fuqinë e tyre votuese sepse shpeshherë votat e elektoratit të tyre shpërndahen për kandidatët e partive tjera.

▪ Anëtarët e një partie politike kur votojnë edhe për kandidatët e partive tjera i bëjnë konkurrencë kandidatëve të partive të tyre.

▪ Disa herë partitë me shumicë relative të votave mund të fitojë shumicë absolute të mandateve të deputetëve.

▪ Me këtë sistem zgjedhor, mund të ketë raste ku deputetët e parlamentit mund të zgjidhen vetëm përfaqësuesit e një partie politike duke mbetur parlamenti pa opozitë.

#### *Vota Bllok partiake*

Ky sistem organizohet në zonat zgjedhore shumë kandidatësh dhe përngjan për një nuancë me sistemin zgjedhor “I pari listës merr postin”, për shkak se votuesi këtu ka vetëm një votë, ndërsa ka elemente të sistemit “vota bllok”, sepse zonat elektorale janë shumë kandidatësh. Votuesi në këtë sistem voton jo për kandidatin konkret por për partinë politike. Cilado parti që ka fituar më së shumti vota, në atë njësi zgjedhore, i fiton të gjitha mandatet e asaj njësie zgjedhore dhe sipas rregullit, zgjidhet e gjithë lista e kandidatëve të asaj partie politike. Ky sistem zgjedhor është shumë karakteristik, sepse një parti politike mund të fitojë shumicën e votave gjatë zgjedhjeve por të mos e merr numrin më të madh të mandateve në parlament. E kemi rastin në SHBA, në zgjedhjet presidenciale kandidati për president mund të humb vota popullore, por duke i fituar shumicën e votave të kolegjit elektoral mund të zgjidhet president i saj. Edhe në këtë sistem zgjedhor, nuk kërkohet të fitohet shumica absolute e votave, mjafton që njëra prej listave partiake të fitojë më shumë vota, në raport me partitë e tjera, që marrin pjesë në zgjedhje, ajo parti fiton të gjitha mandatet parlamentare.

Ky variant i sistemit mazhoritar përdoret për të siguruar përfaqësimin e baraspeshuar etnik, meqë kjo u mundëson partive të paraqesin lista të kandidatëve për zgjedhje me baza të ndryshme etnike. P.sh. në Liban secila listë partiake duhet të përbëhet nga kandidatë, nga grupe të

ndryshme etnike. Edhe ky sistem aplikohet mjaftë rrallë sepse një parti, mund të fitojë gati të gjitha mandatet e deputetëve në legjislaturë me një shumicë të thjeshtë të votave.<sup>22</sup>

### **Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi**

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Është i lehtë për t'u kuptuar nga votuesit dhe i lehtë për t'u administruar nga organet që bëjnë administrimin e zgjedhjeve
  - Mundëson që grupet e vogla etnike më lehtë të përfaqësohen në organet përfaqësuese, sidomos në ato shtete ku në çdo listë partiake duhet të figurojnë kandidatët që përfaqësojnë grupe të ndryshme etnike.
  - Krijojnë mundësinë që një parti e vetme të fitojë shumicën absolute të mandateve për të formuar në mënyrë të pavarur qeverinë.
- Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:
- Lidërshipi i partisë shpeshherë imponon kandidatë nëpër listat e partisë të cilët, nuk janë të pëlqyer nga votuesit, por ata votojnë edhe për ta, sepse votimi bëhet me listë.
  - Mundësia që një parti e vetme të fitojë të gjitha mandatet e deputetëve në legjislaturë dhe në parlament të mos ketë fare opozitë.

#### *Vota alternative*

Sistemi i votës alternative në teori njihet edhe si sistemi i zgjedhjeve preferenciale. Në këtë sistem zgjedhor secili zgjedhës ka në dispozicion numër të caktuar të votave për t'i dhënë për kandidatët sipas preferencave të tyre. Sipas votës alternative, votuesit shënojnë në listën e kandidatëve preferencat e tyre, duke filluar me preferencën e parë, të dytë, të tretë e kështu me radhë. Pra votuesit i jepet mundësia të bëjë radhitjen e kandidatëve në listë sipas vlerësimit personal. Kandidati për të fituar duhet të fitojë shumicën absolute të preferencës së parë. Por nëse asnjë kandidat nuk ka fituar shumicën e votave të preferencës së parë, atëherë vazhdohet me numërimin e preferencave të tjera derisa një kandidat ka marrë shumicën e preferencave.<sup>23</sup>

Ky sistem zgjedhor përdoret në Australi për zgjedhjen e deputetëve në Dhomën e Përfaqësuesve, që nga vitit 1919, në Angli për

<sup>22</sup> Sadik Haxhiu, "Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)", Prishtinë, 2013, f. 200-201.

<sup>23</sup> Roger Mortimore, "A guide to the Alternative votes, social research institute", February, 2011, ose Arend Lajphart, "Modeli demokratije", Beograd, 2003, f. 174.

zgjedhjen e kryebashkiakut të Londrës<sup>24</sup> në Irlandë për zgjedhjet presidenciale, për zgjedhjet vendore në Skoci dhe Irlandë të Veriut. Në një formë disi më të modifikuar ky sistem përdorej në Fixhi.<sup>25</sup> për dallim nga sistemet tjera zgjedhore, te ky sistem kërkohet një arsimim dhe një përgatitje më e lartë për administruesit e zgjedhjeve, pasi është një procedurë mjaft komplekse, veçanërisht gjatë numërimit të fletëvotimeve.

### **Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi**

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Ofron koalicione të ndryshme parazgjedhore në mes partive të ndryshme politike me qëllim të këmbimit të votave.

- U mundëson përkrahësve të kandidatëve që kanë pak shpresë për t'u zgjedhur, të influencojnë zgjedhjen e kandidatit kryesor përmes preferencës së dytë apo tretë.

- Siguron një lidhje të plotë ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur dhe njësisë zgjedhore në kuptimin gjeografik të fjalës.

Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:

- Që ky sistem zgjedhor të mund të aplikohet në mënyrë efektive, kërkon që votuesit të dinë për të bërë kalkulime se ku shkon vota e tyre.

- Ky sistem nuk është rezistencë ndaj manipulimeve zgjedhore.

- Votuesit duhet të kalkulojnë mirë që kur të jep votat e dyta, të treta e kështu me rradhë të pretendojë t'i votojë kandidatët që supozohet se nuk rrezikojnë kandidatin pretendent të tyre.

### *Sistemi dy raundesh apo sistemi i balotazhit*

Ky sistem është i njohur ndryshe si sistemi i dyfishtë i votimit ose sistemi i shumicës absolute dhe hynë në kategorinë e sistemeve mazhoritare zgjedhore që karakterizohen nga zhvillimi i më shumë se një raundi votimi. Ky sistem zhvillohet në zonat zgjedhore një-emërore. Sipas këtij varianti të shumicës, si deputet i zgjedhur cilësohet ai kandidati i cili në njësinë përkatëse zgjedhore, në raundin e parë zgjedhor, ka fituar shumicën absolute, respektivisht gjysmën nga numri i përgjithshëm i votave të parashikuara – plus një. Në të kundërtën, nëse asnjë nga kandidatët e mundshëm nuk ka fituar shumicën absolute, atëherë dy kandidatët që kanë fituar më shumë vota kalojnë për në raundin e dytë të votimeve. Por ka edhe përjashtime, ku në disa shtete në raundin e dytë

<sup>24</sup> Ylli Bufi, “Tempulli i demokracisë”, OMBRA GVG, Tiranë, 2010, f. 191.

<sup>25</sup> Etem Aziri, “Partitë Politike, Zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore”, Tetovë, 2015, f. 437.

shkojnë të gjithë ata kandidatë që kanë fituar në raundin e parë zgjedhor një përqindje të caktuar të votave të parashikuara me ligj. Në Francë gjatë zgjedhjeve parlamentare, të drejtën e kalimit në balotazh e fitojnë të gjithë kandidatët që kanë fituar në raundin e parë të paktën 12.5% të votave të votuesve të regjistruar për atë njësi zgjedhore. Në raundin e dytë zgjedhor shpallet fitues ai kandidat që ka siguruar shumicën relative të votave të parashikuara për ata njësi zgjedhore. Këtë e theksojmë qëllimisht, pasi gjatë përcaktimit të njësisve zgjedhore, ndodh që numri i votuesve për njësi zgjedhore të mos jetë i njëjtë, ose dallimet të jenë mjaft të shprehura.<sup>26</sup>

Sistemi i balotazhit, më së shumti përdoret në zgjedhjet presidenciale, aty ku presidenti i shtetit zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt. Por në disa raste të zgjedhjeve presidenciale, sipas sistemit të balotazhit, ndodh që një kandidat të shpallet fitues në raundin e parë pa shumicën e votave, me kusht që ai të plotësojë disa norma të caktuara, si p.sh. të marrë të paktën 45% të votave të hedhura dhe të kryesojë me të paktën 15% më shumë se kandidati i dytë.

Ky sistem aplikohet në zgjedhjet parlamentare në Francë, Belgjikë si dhe në zgjedhjet presidenciale në Slloveni, Austri, Finlandë, Portugali, Rusi etj.

### **Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi**

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Mundësohet krijimi i qeverisë së fortë dhe të qëndrueshme, sikurse te sistemi i pari i listës merr postin.<sup>27</sup>

- Ky sistem zgjedhor është i përshtatshëm dhe i lehtë për t'u aplikuar, sepse kërkon një teknikë të lehtë të organizimit dhe të zbatimit të tij, duke filluar që nga hartimi i fletëvotimeve, numërimi i tyre e deri te shpallja e rezultateve përfundimtare.

- Ndikon në lidhjen e koalicioneve politike, në mes të partive politike, në mënyrë që në rrethin e dytë (balotazh) ato do të përkrahin njërin nga dy kandidatët.

Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:

- Është sistem elektoral, që kërkon një kosto të lartë të organizimit dhe të zbatimit të zgjedhjeve, sepse edhe pas dy javëve kur rëndom organizohet raundi i dytë i zgjedhjeve, kërkohen shpenzime të njëjta.

<sup>26</sup> Etem Aziri, "Partitë Politike, Zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore", Tetovë, 2015, f. 439.

<sup>27</sup> Andrew Heywood, "Politika", vepër e cituar, f. 216.

- Pakicat që nuk kanë një elektorat të koncentruar mund të eliminohen në mënyrë drastike.
- Ka rënie drastike të pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje në raundin e dytë.
- Shpallja e rezultateve përfundimtare zgjat më shumë se në sistemet tjera të votimit, prandaj në vendet që nuk kanë stabilitet të mjaftueshëm politik, mund të çojë në pasiguri dhe mungesë stabiliteti.
- Ndërmjet dy raundeve zgjedhore bëhen shumë “pazare politike” midis partive, kandidatët e të cilave janë akoma në “lojë” e që nuk janë përfunduar krejtësisht nga kalkulimet politike.

### **Conclusion**

Electoral systems differ according to some of their constituent elements, such as the size of the electoral area, the size of the legislature, the structure of the vote, the mathematical formula for the distribution of seats, or the electoral lists of the parties. But the most important element of an electoral system is the electoral formula, which is also the basis of the categorization of systems.

Majoritarian systems are based on ‘the winner-takes-all’ method and tend to produce an absolute winner and a series of losers, producing the model of majoritarian democracy.

Majority systems exert influence through 'mechanical' and 'psychological' factors on the party system, producing a two-party system. The mechanical factor has to do with the fact that only the big parties can win the elections, while the psychological factor reinforces the mechanical one as voters are oriented towards supporting one of the two big parties so that their vote 'doesn't go to waste'. But the psychological factor also affects politicians who join big parties instead of spending energy to compete with parties whose chances of victory are low. Because majoritarian systems give large parties the majority of seats in parliament even when they do not receive the majority of votes, they affect representativeness as they produce high turnover. This has a direct impact on the number of parties, since the higher the voter turnout, the more the number of parties entering parliament decreases.

One of the critical aspects of majoritarian systems is that the government is theoretically controlled by the parliament, but in practice, since it consists of leaders of the same political party, it actually dominates the parliament. In this way, more than a parliamentary

system, majoritarian democracy is seen as a concentration of power in a two-party system disciplined and dominated by the executive.

However, majoritarian systems are essentially democratic and allow the normal functioning of a liberal democracy. In many established democracies, mainly Anglo-Saxon countries and countries influenced by them, majoritarian systems continue to be preferred over proportional ones.

**Recensentë:**

**Prof. Dr. Etem Aziri**

**Prof. Dr. Elena Andreevska**

**Referencat:**

- Andrew Heywood, *Politika*, Prishtinë, 2008
- Andrew Reynolds, Ben Relly, Andrew Ellis, *Electoral System Design: The New International Idea Handbook*, Stockholm, 2008
- Donatella Della Porta, *Bazat e shkencës politike*, Prishtinë, 2006
- Etem Aziri, *Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore*, Tetovë, 2015
- Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: formimi, sfidat dhe prespektiva e zhvillimit demokratik*, UEJL, Tetovë, 2012
- Oreta Saliaj, *Ndikimi i zgjedhjeve dhe sistemit zgjedhor në demokracizimin e sistemit politik të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2014
- Roger Mortimore, *A Guide to the alternative vote*, social research institute, 2011
- Arend Lijphart, *Electoral System and Party Systems; A study of Twenty-Seven Democracies: 1945-1990*, Oxford, 1994
- Sadik Haxhiu, *Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)*, Prishtinë, 2013
- V. Vasoviq, V. Goati, *Izbori i izborni sistemi*, Beograd, 1993
- Vladimir Goati, *Politicke Partije i Izbori u Demokratskom Poretku*, Centar za Slobodne Izbore i Demokratiju – CESID, Beograd, 2001
- Ylli Bufi, *Tempulli i Demokracisë*, Tiranë, 2010
- “*The systems and their consequences, extracted from Electoral system design*”, New International IDEA Handbook, 2005
- *The Report of the Independent Commission on the Voting System*, <http://www.officialdocuments.co.uk./document/crn40/4090/contents.htm>. 1998